

INDEKSI PËR GJITHËPËRFSHIRJE - FAKTE DHE OPINIONE

Dr. Naser Zabeli & Ma. Lulavere Behluli

Autorët:

Dr. Naser Zabeli
Ma. Lulavere Behluli

Mbështetur nga:

Save the Children
- Programi i Implementimit
- Programi për Zhvillim dhe Kualitet

Korrektimi:

Greta Kaqinari

Dizajni, faqosja dhe shtypi:

Envion

Botuar nga:

Save the Children
Gazmend Zajmi, nr. 01
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
Fax: +381 (0) 38 23 26 93
scik@savethechildren.org
http://kosovo.savethechildren.net

Copyright © 2014, Save the Children

Te gjitha të drejtat i përkasin Save the Children në Kosovë. Raporti mund të riprodhohet me çdo metodë, pa pagesë apo leje paraprake për qëllime mësimore, por jo për rishitje. Për përdorimin në çfarëdo rrethane tjetër, leje paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children.

Si pjesë e sistemit të llogaridhënjes së Save the Children: Nëse keni ndonjë ankesë, reagim apo pyetje, ju lutemi t'i ndani ato me ne në scik@savethechildren.org

Përmbajtja

Konteksti	5
Edukimi gjithëpërfshirës - përkufizimi	6
Edukimi gjithëpërfshirës në Kosovë	8
Indeksi për gjithëpërfshirje	10
Procesi i zbatimit të Indeksit në institucione parashkollore dhe shkolla	14
Metodologjia e hulumtimit	20
Praktika të mira nga zbatimi i Indeksit në institucione parashkollore dhe shkolla	21
Sfidat /vështirësitë e zbatimit të Indeksit në institucionet arsimore në Kosovë.....	29
Konkluzione dhe rekomandime	31
Literatura	32

Lista e tabelave dhe figurave

Figura 1. Trekëndëshi i gjithpërfshirjes	11
Figura 2. Fazat e zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje	12
Tabela 1: Modeli i zbatimit të Indeksit për Gjithëpërfshirje (shkollat e para të përfshira, nga viti 2006 deri 2013)	15
Tabela 2: Shembull i prezantimit të punës me rastin e monitorimit nga ana e trajnerëve	16
Tabela 3: Lista e Institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore.....	17
Tabela 4: Monitorimi për Institucione Parashkollore dhe Shkolla.....	18
Tabela 5: Përfshirja e Indeksit në Planin zhvillimor të shkollës –model nga shkolla fillore “Migjeni” Mitrovicë	19
Tabela 6: Institucionet e përfshira në hulumtim dhe numri i pjesëmarrësve.....	20
Tabela 7: Pjesëmarrësit në fokus grup	20
Tabela 8: Ndryshimet në institucion.....	22
Tabela 9: Rekomandime nga edukatorët / mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit	24
Tabela 10. Lista e institucioneve parashkollore dhe shkollave të cilat i kanë fituar grantet e ndara nga ana e Save the Children:	28

Lista e akronimeve

MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit
RAE - Romë, Ashkalinë dhe Egjiptas
UNMIK- United Nation Mission In Kosovo
FSDEK – Finnish Support to the Development of Education in Kosovo
UNICEF - United Nation Children's Rights & Emergency Relief Organization
KKK - Korniza e kurrikules se Kosoves
PSAK -Plani Strategjik per Arsimin e Kosoves
PIA - Plani individual i arsimit
OJQ- Organizata Jo-Qeveritare

Fjalë hyrëse

Indeksi për gjithëpërfshirje është një instrument i cili u ndihmon shkollave për t'u zhvilluar si shkolla gjithëpërfshirëse dhe mësimdhënëse gjithëpërfshirës. Ne kemi pasur fatin që nëpërmjet Save the Children të takohemi me autorin e parë të këtij dokumenti (Tony Booth) dhe në konsultim me të, të bëjmë përshtatjen për kontekstin kosovar. Gjithashtu, për të qenë edhe më konkret në këtë përshtatje, kemi zhvilluar edhe punëtori me edukatorë të institucioneve parashkollore dhe mësimdhënëse të shkollave të Kosovës (shkollë fillore dhe shkollë e mesme e ultë).

Në disa komuna të Kosovës, mbi bazën e këtij dokumenti, kemi zhvilluar edhe punëtori për të zbatuar gjithëpërfshirjen sipas metodologjisë të Indeksit për Gjithëpërfshirje. Kjo, fillimisht ka qenë një sfidë edhe për ne, pasi që ishte një metodë e re, një qasje më ndryshe, më konkrete e më praktike dhe e cila kërkon që, pas trajnimeve, të zhvillohen punë konkrete në institucione.

Pas disa punëtorive të zhvilluara me institucione parashkollore dhe me shkolla fillore e të mesme të ulta, kemi zhvilluar edhe një *hulumtim*. Prandaj, kemi kënaqësinë që t'i paraqesim disa fakte dhe opinione të dala nga punëtoritë dhe nga *intervistat të hapura të zhvilluara me edukatorë, mësimdhënëse, nxënës e prindër, fakte dhe opinione të dala nga institucionet dhe vendet të Kosovës ku janë zhvilluar trajnimet si dhe nga një fokus grupi në të cilin janë përfshirë: staf menaxhues nga drejtoritë komunale të arsimit, drejtorë të institucioneve parashkollore dhe shkollore, edukatorë, mësimdhënëse dhe nga zyra e Save the Children.*

Faktet dhe opinionet e paraqitura, do të mund të shërbejnë si një model dhe mundësi për të inkurajuar MASHT, DKA, institucionet parashkollore dhe shkollore me një fjalë, të gjithë komunitetin arsimor, për të inicuar dhe zbatuar gjithëpërfshirjen sipas metodologjisë së Indeksit për gjithëpërfshirje.

Me këtë rast, me shumë kënaqësi, duam të falënderojmë të gjithë edukatorët, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, drejtorët e zyrtarët e arsimit, të cilët me gatishmërinë dhe opinionet e tyre kotribuan në dokumentimin e ndikimit të zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet tona.

Autorët

I. Konteksti

Edukimi gjithëpërfshirës është një sfidë për të gjitha vendet që synojnë të realizojnë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pa dallim feje, kulture, race gjinie e çdo diversiteti tjetër, gjë që është e drejtë themelore e çdo njeriu. Në shume sisteme arsimore të vendeve të ndryshme gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë sfidë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bënë përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të edukimit gjithëpërfshirës.

Ndryshimet që kane ndodh në Kosovë viteve të fundit, patën ndikime të fuqishme edhe në fushën e arsimit. Reformimi i arsimit krahas shumë risive ka sjelle edhe nocione dhe koncepte të reja në trajtimin dhe vendin që duhet të këtë arsimit gjithëpërfshirës në kuadër të sistemit arsimor. Andaj, arsimit gjithëpërfshirës përfshin adoptimin e një vizioni të gjerë për arsimimin e të gjithëve duke marrë parasysh nevojat e të gjithë fëmijëve, duke përfshirë edhe ata që janë të rrezikuar nga marginalizimi dhe përjashtimi.

Në Republikën e Kosovës, krahas zhvillimeve shumë pozitive në arsim, statistikisht rreth mospërfshirjes së fëmijëve në shkollim ende mund të konsiderohen shqetësuese. Kjo në radhë të parë të fëmijëve me nevoja të veçanta (me dëmtime të renda dhe të shumëfishta) dhe të minoriteteve, veçmas të Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve (RAE). MASHT është në përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e kushteve në të gjitha drejtimet për përfshirjen sa më të madhe të të gjithë fëmijëve në institucionet arsimore. Në këtë kuptim, hapa shumë pozitiv janë bërë në drejtim të gjithëpërfshirjes (inkluzionit), baza e të cilit gjendet në arsimin special.

Arsimi special në Kosovë funksionon që nga viti 1950, kur edhe fillon funksionimi i shkollave speciale. Në këto shkolla speciale ofrohej arsimim për një numër të vogël të fëmijëve duke marrë parasysh numrin e vogël të shkollave dhe kuadrin joprofesional. Gjatë periudhës (1990-1999) kanë funksionuar katër shkolla speciale dhe katër klasë të bashkangjitura në kuadër të shkollave të rregullta. Ky arsimim që ende ishte segregues në raport me gjithëpërfshirjen, vazhdoi si i tillë deri në vitin 2000. Nga viti 2000, fillon një periudhë e re për arsimin kosovar, në përgjithësi dhe arsimin special në veçanti. Bëhet fjalë për përqindje më të madhe të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollim dhe për avancim të infrastrukturës ligjore.

Në fillim të kësaj periudhe, paralelisht me themelimin dhe funksionimin gradual të Ministrisë së Arsimit Shkencës e Teknologjisë (fillimisht nën udhëheqjen e UNMIK-ut), disa agjenci ndërkombëtare nisin të mbështesin ndër të tjera edhe sektorin e arsimit special. Këtu vlen të përmendet: Save the Children, Përkrahja Finlandeze në Zhvillimin e Sektorit të Arsimit Special në Kosovë (e njohur si: FSDEK – Finnish Support to the Development of Education in Kosovo), UNICEF, Handikos etj.

Periudha e pas vitit 2000, shënon përparim drejt zhvillimit të një varg dokumentesh nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (funksionon edhe sektori i arsimit special si njësi e veçantë) të cilat janë të orientuara drejt gjithëpërfshirjes (inkluzionit).

2. Edukimi gjithëpërfshirës - përkufizimi

Ekzistojnë shume ide dhe përkufizime për gjithëpërfshirjen dhe është e vështirë të analizohen të gjitha por ne do të mbështetemi të ato përkufizime të cilat pasqyrojnë atë që e quajmë gjithëpërfshirje.

Edukimi gjithëpërfshirës, synon edukimin e të gjithë fëmijëve në përputhje me moshën e tyre, në përshtatje me mundësitë dhe nevojat e tyre të veçanta në mjedise shkollore të përbashkëta. Kjo është një praktikë bashkëkohore ndërkombëtare e pranuar si forma më e përshtatshme e realizimit të së drejtës për arsim, si e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve “pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë (Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijës, 1989). Arsimi gjithëpërfshirës do të thotë me tepër se sa prania e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta. Ai është zhvilluar nga një histori e gjatë e risive arsimore dhe paraqet përmirësimin e shkollës në shumë nivele për të gjithë nxënësit (Skrtic, Sailor dhe Gee, 1996) dhe ka të bëjë me promovimin e dinjitetit dhe dallimeve (Barton, 1997).

Arsimi gjithëpërfshirës është në dobi jo vetëm të fëmijëve që vijnë nga grupet e marginalizuara dhe me vështirësi në të mësuar. Nga arsimi gjithëpërfshirës përfitojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht faktit nëse janë me nevoja të veçanta apo jo, pasi dihet që të gjithë nxënësit i kanë veçantitë e veta të mënyrës së të nxënës dhe të të shprehurit. Edukimi gjithëpërfshirës jo vetëm që i pranon të gjithë nxënësit në sistemin e përgjithshëm arsimor, por edhe i nxit këta të fundit t'i përshtaten nevojave të veçanta të të gjithë nxënësve. Sipas Indeksit, gjithëpërfshirja ka të bëjë me edukimin dhe arsimimin e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve. Komponentet themelore që e përbëjnë përkufizimin për gjithëpërfshirjen sipas Indeksit për gjithëpërfshirje¹ (Both dhe Ainscow).

- Vlerësimi i barabartë i të gjithë nxënësve dhe punonjësve.
- Rritja e nivelit të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin mësimor dhe zvogëlimi i mospërfshirjes së tyre në kulturat, plan-programet dhe në bashkësitë e shkollave.
- Ristrukturimi i kulturave, politikave dhe praktikave nëpër shkolla, në mënyrë që ato t'i përgjigjen diversitetit të nxënësve në lokalitet.
- Zvogëlimi i pengesave në mësimnxënie dhe në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor për të gjithë nxënësit, pra jo vetëm për ata me pengesa apo ata që emërtohen si “nxënës me nevoja të veçanta në shkollim”.

- Marrja e përvajave nga përpjekjet për tejkalimin e pengesave në qasjen dhe pjesëmarrjen e disa nxënësve në krijimin e ndryshimeve në të mirë të nxënësve në përgjithësi.
- Të kuptuarit e dallimeve mes nxënësve si burim për përkrahjen e mësimnxënies e jo si probleme që duhet të zgjidhen.
- Pranimi i së drejtës së nxënësit për t'u edukuar e arsimuar në vendin ku jeton.
- Përmirësimi i shkollave si për punëtorët e arsimit ashtu edhe për nxënësit.
- Theksimi i rolit të shkollës në ndërtimin e bashkësisë apo të komunitetit dhe në krijimin e vlerave, si dhe në rritjen e rezultateve.
- Avancimi i marrëdhënieve të ndërsjella mes shkollave dhe bashkësive.
- Pranimi i faktit se gjithëpërfshirja në sistemin edukativo-arsimor është një aspekt i përfshirjes në shoqëri.

Arsimi gjithëpërfshirës nuk është thjesht një rregullim i pjesshëm i sistemit të edukimit, por rinovim tërësor i tij dhe reformë e thellë e shkollës (Stangvik, 1997). Një shkollë për të gjithë. Zbatimi i reformës së arsimit gjithëpërfshirës krijon kushtet për një sistem arsimor, që përfshin brenda vetes një shumëllojshmëri nxënësish dhe që e diferencon edukimin sipas kësaj shumëllojshmërie.

¹ Booth, Tony. Ainscow, Mel. Përshtatur në gjuhën shqipe nga Zabeli, Naser dhe Behluli, Lulavere. 2011. Indeksi për gjithëpërfshirje. Prishtinë: Save the Children.

3. Edukimi gjithëpërfshirës në Kosovë

Në Kosovë janë hedhë hapat të rëndësishëm drejt hapjes së shkollave të rregullta si për fëmijët me nevoja të veçanta ashtu edhe për fëmijë të tjerë, mirëpo ky proces po has në disa pengesa sidomos në të kuptuarit të drejtë të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës nga institucionet arsimore nga niveli qendror deri në nivele shkollore.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, arsimin gjithëpërfshirës e ka përfshirë si filozofi e cila i përshkon të gjitha politikat e saj duke filluar nga legjislacioni e deri të dokumentet tjera përcjellëse të cilat e promovojnë arsimin gjithëpërfshirës:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës 2011 - Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin i cili është i bazuar në deklaratën e Salamankes mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën mbi të drejtat e njeriut.
- Korniza e kurrikulës së Kosovës (KKK) (2010), -Një nga parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar KKK është gjithëpërfshirja. KKK është në linjë me Arsimin për të Gjithë dhe Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit.
- Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet (2011), - siguron qasje gjithëpërfshirëse në edukimin e hershëm ku në qendër është fëmija dhe arrijtet e tij në fusha të ndryshme zhvillimi në përputhje me moshën e tij.
- Standardet për shkollat mike për fëmijë (2012)- Koncepti i shkollave mike për fëmijë mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlihd aspektet e reformës në arsim dhe e cila e vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë.
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës (PSAK) 2011-2016, është një plan pesëvjeçar që lidh arsimin gjatë gjithë jetës me përfshirjen në arsim dhe është një model për t'i arritur të gjithë nxënësit si dhe ofron mundësi të barabarta për arsimim cilësor për të gjithë. Në këtë plan strategjik arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet Planit strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja te veçanta në arsimin parauniversitar 2010-2015, dokument ky i cili është hartuar ne vitin 2010.
- Plani individual i arsimit PIA (2013), është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendimin për edukim dhe arsimim me nevoja të veçanta.



Krahas zhvillimit të politikave, këtë proces e kanë ndihmuar edhe bashkëpunimi me projekte të ndryshme të cilat me përvojat e tyre të zhvilluara në Kosovë kanë mundësuar krijimin e modeleve pozitive dhe funksionale për kontestin dhe rrethanat tona sidomos në përfshirjen e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta në institucione arsimore të rregullta siç janë institucionet parashkollore dhe shkollore, dhe në veçanti kontribut të rëndësishëm kane dhënë Save the Children, projektet finlandeze, UNICEF etj. Disa prej aktiviteteteve të rëndësishme janë:

- organizimi i një numri të konsiderueshëm të trajnimeve me mësime mbështetëse,
- shndërrimi i shkollave speciale në Qendra burimore,
- krijimi i institucioneve parashkollore dhe shkollore gjithëpërfshirëse
- inkuadrimi i edukatorëve dhe mësime mbështetëse
- publikimi i punimeve, librave e udhëzuesve për problematikën e arsimit gjithëpërfshirës, etj.
- fillimi i zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të ulta që implementohet nga Save the Children në partneritet me MASHT

4. Indeksi për gjithëpërfshirje

Çfarë është Indeksi për gjithëpërfshirje?

Indeksi për gjithëpërfshirje është instrument i cili i ndihmon shkollës për t'u zhvilluar përmes modelit gjithëpërfshirës, duke siguruar ndryshime afatgjata në strukturë, mësim dhe në fusha të ndryshme të shkollës.



Përmbajtja e Indeksit:

- Nocionet kryesore (gjithëpërfshirje, pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive
- në procesin mësimor, përkrahja e ndryshueshmërive – diversiteteve),
- Dimensionet dhe fushat:

A) Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse,

B) Krijimi i politikave të përfshirjes,

C) Krijimi i praktikave të përfshirjes.




Figura 1. Trekëndëshi i gjithpërfshirjes

Treguesit dhe pyetjet

Indeksi për gjithëpërfshirje përbëhet nga seksionet ku secili prej tyre ka 5-11 tregues. Çdo tregues paraqet aspekt të rëndësishëm për shkollën edhe pse disa çështje më të ndjeshme siç janë minoritetet, nxënësit me nevoja të veçanta pasqyrohen në të gjithë treguesit. Domethënia e çdo treguesi është e shpjeguar me anë të një numri pyetjesh të cilat kristalizojnë gjendjen aktuale në shkollë, ofrojnë ide shtesë për aktivitetet zhvillimore dhe shërbejnë si kriter i përparimit.

Procesi gjithëpërfshirës përfshinë pesë faza:

1. Fillimi i punës me Indeks,
2. Informatat për shkollën,
3. Hartimi i planit të shkollës për përfshirje në shkollim,
4. Prioritetet për zbatim,
5. Shqyrtimi i procesit të Udhëzuesit – vlerësimi.

2 Përmbajtje e shkurtër nga Indeksi për gjithpërfshirje në gjuhën shqipe

DIMENSIONI A – *Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse*, i referohet zhvillimit të vlerave të përbashkëta gjithëpërfshirëse dhe raporteve bashkëpunuese.

Fusha A.1 - Ndërtimi i bashkësisë,

Fusha A.2 - Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse.

DIMENSIONI B – *Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse*, mundëson që gjithëpërfshirja të gërshetohet në planet e shkollës dhe jep strategji për ndryshime.

Fusha B.1 - Krijimi i shkollës për të gjithë,

Fusha B.2 - Organizimi i përkrahjes për ndryshueshmërinë.

DIMENSIONI C – *Krijimi i praktikave gjithëpërfshirëse*, zhvillon praktikën shkollore e cila ngrit kulturën dhe politikën gjithëpërfshirëse shkollore.

Fusha C.1 - Organizimi i procesit të mësimit dhe të nxënimit,

Fusha C.2 - Mobilizimi i resurseve.

Faza 1 -Fillimi i punës me Indeks (gjysma e gjysmëvjetorit):

- Formimi i grupit bashkërendues – koordinues;
- Shqyrtimi i qasjes në zhvillimin e shkollës;
- Analizimi i njohurive ekzistuese duke i përdorur nocionet dhe kornizën për shtjellim;
- Thellimi i analizës duke i përdorur treguesit dhe pyetjet;
- Përgatitja për të punuar me grupe të tjera.

Faza 2 - Marrja e informatave për shkollën (një gjysmëvjetor):

- Shtjellimi i njohurive të punonjësve;
- Shtjellimi i njohurive të nxënësve;
- Shtjellimi i njohurive të prindërve/kujdestarëve dhe anëtarëve të bashkësisë;
- Caktimi i prioriteteve për zhvillim.

Faza 3 -Hartimi i planit gjithëpërfshirës për zhvillimin e shkollës:

- Revidimi ose krijimi i planit gjithëpërfshirës zhvillimor të shkollës,
- Analizimi dhe caktimi i prioriteteve në planin zhvillimor të shkollës.

Faza 4 -Zbatimi i prioriteteve:

- Zbatimi i prioriteteve në praktikë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Vlerësimi i procesit të udhëzuesit.

Faza 5 - Përcjellja e punës dhe rishikimi (i vazhdueshëm) i procesit:

- Vlerësimi i zhvillimeve;
- Rishikimi i punës me udhëzues;
- Vazhdimi i procesit të udhëzuesit.




Figura 2. Fazat e zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje

5. Procesi i zbatimit të Indeksit në institucione parashkollore dhe shkolla

Indeksi për gjithëpërfshirje përdoret në shumë vende të botës si instrument i përshtatshëm për zhvillimin e shkollave gjithëpërfshirëse dhe ky dokument është përshtatur dhe ka filluar të përdoret edhe në Kosovë që nga viti 2007 me përkrahjen e Save the Children. Indeksi për gjithëpërfshirje është përfshirë në Planin Strategjik për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar 2011-2015 e cila është pjese e Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2010-2016 (PSAK). Fillimisht Indeksi për gjithëpërfshirje nga ana e Save The Children ka filluar të zbatohet nga viti 2006 në dy shkolla të komunës së Prizrenit (“Ibrahim Fehmiu” dhe “Haziz Tolaj”).

Më pas, në vitin 2010, Save The Children nënshkruan marrëveshjen e mirëkuptimit me MASHT lidhur me zbatimin e Indeksit për gjithëpërfshirje. Fillimisht u shtrua nevoja e adaptimit të udhëzuesit për nevojat e Kosovës dhe procesit të adaptimit të udhëzuesit i ka paraprirë vizita studimore në Londër - Angli në Qershor të vitit 2010, ku gjatë kësaj vizite u krijuan mundësi të njohjes dhe shkëmbimit të përvojave me njërin nga autorët e hartimit të Indeksit për gjithëpërfshirje, Tony Booth. Kjo vizitë gjithashtu krijoi një pasqyrë të qartë të përparësive që ka përdorimi i tij në shkolla dhe institucione tjera arsimore. Pas kthimit nga vizita, filloi puna në adaptimin e Indeksit dhe në këtë proces u përfshinë edhe shkollat në mënyrë që instrumenti të jetë i përdorshëm dhe i përshtatshëm me kontekstin e kulturës së shkollave në Kosovë.



Fotografi nga punëtorja e parë e trajnimit me mësimdhënës të shkollave: “Ibrahim Fehmiu” dhe “Haziz Tolaj” në Prizren

Puna në kuadër të shkollave si rezultat i realizimit të Indeksit për Gjithëpërfshirje

- Prizreni– 2006/2007
- SAVE THE CHILDREN
- INICIATIVA 6
- Trajner : Prof. Dr . Naser Zabeli
- 2006 - 25 mësimdhënës të të dy shkollave: “Ibrahim Fehmiu” dhe “Haziz Tolaj”
- Janar 2007 – Hulumtimi rreth prioriteteve rreth infrastrukturës së shkollës riformulimi i pyetësorëve

(Zhvillimi i hulumtimit Prill - Shtator 2007 – Rezultatet e dala: I. Sjellja jo e mirë e arsimtarëve, Mosmbajtja e mësimit në kabinetin e gjuhës angleze, Sjellja jo e mirë e shokëve).

- 2008 - Raporti jo i mirë në mes nxënësve dhe mësimdhënësve – debatet me nxënës, mësimdhënës dhe prindër.

Shembuj të prioriteteve të dala nga këto shkolla :

- Dallimi, veçimi dhe përkrahja e disa nxënësve të veçantë në krahasim me të tjerët).
- Debate
- Këto debate njëkohësisht shërbyen edhe si hulumtim shtesë!
- Shkaqe të braktisjes
- Ndalimi i ngacmimeve – mbledhjet e shpeshta,
- Organizimi i seminareve për prindër për qëllim të vetëdijesimit të tyre.
- Masa të tjera për përmirësimin e shkollës:
- Takimet më të shpeshta me prindër,
- Hulumtimi tjetër në Maj 2012.

Shembull: Ushtrimi i dhunës fizike, psikike dhe ekonomike nga disa mësimdhënës dhe nxënës. Ngacmimet në shkollë.

- Aktivitetet për vitin 2012-2013
Shembull i prioriteteve: Braktisja e shkollimit nga nxënësit me theks të veçantë të komunitetit RAE.
- Më 13.12.2013, është bërë identifikimi i nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin gjatë këtij viti shkollor nga klasa e parë deri në të nëntën.
- Më 14.12.2012, është mbajtur debat me nxënës, prindër si dhe me mësimdhënës me temë diskutimi “Parandalimi i braktisjes së shkollimit nga nxënësit”.
- Konfliktet në shkollë.
- Më 15.12.2012, janë bërë hulumtime me nxënës rreth shkaqeve të konflikteve ndërmjet nxënësve. Rreth kësaj teme kishte mendime të ndryshme .
- Ndërsa, më 16.12.2012, është mbajtur debat rreth shkaqeve të konflikteve ndërmjet nxënësve në shkollë.

06.6.2013

- Shembull i prioriteteve: Vlerësimi i drejtë dhe jo i drejtë

Tabela I: Modeli i zbatimit të Indeksit për Gjithëpërfshirje (shkollat e para të përfshira, nga viti 2006 deri 2013)

FERIZAJ
PREZANTIMI I PUNËS SË GRUPIT BASHKËRENDUES PËR GJITHËPËRFSHIRJE

- Indeksi për gjithëpërfshirje
- Më 29 dhe 30 shtator është mbajtur seminari “Indeksi për gjithëpërfshirje” në restorantin “Orchide” me shkollën fillore “Tefik Çanga” i ligjërues nga profesori Naser Zabeli dhe në të cilin ishin të pranishëm gjithsej 20 mësime të mesimdhënës.
- Indeksi për gjithëpërfshirje është një dokument i cili duhet të implementohet në shkollë përmes punës së vazhdueshme të mësime të mesimdhënësve.
- Në fund të këtij seminari, së bashku me ligjëruesin, janë përzgjedhur anëtarët e grupit të cilët më pas kanë punuar nëpër aktivitete të ndryshme me mësime të mesimdhënësve.

Puna e grupit punues për gjithëpërfshirje gjatë aktivitetit të V dhe të VI.

-Shfrytëzimi i treguesve për të identifikuar shqetësimet fillestare.

-Diskutimi i fakteve

Takimet e grupit punues për gjithëpërfshirje:

-Diskutimi dhe lidhja e treguesve dhe pyetjeve me kulturat, politikat dhe praktikën në shkollë

Puna në grupe gjatë takimeve të grupit punues për gjithëpërfshirje:

- Rishikimi i të gjithë treguesve dhe pyetjeve.
- Përdorimi i fletës përmbledhëse për nxjerrjen e prioriteteve.
- Identifikimi dhe tejkalimi i pengesave në përdorimin e Indeksit
 - Më 12.03.2013, profesor Naser Zabeli ka qenë për vizitë në shkollën tonë për monitorimin e punës disa mujore.
 - Grupi bashkërendues për gjithëpërfshirje ka prezantuar punën e tyre disa mujore dhe rezultatet e arritura.

Tabela 2: Shembull i prezantimit të punës me rastin e monitorimit nga ana e trajnerëve

Në këtë fazë u zgjodhën 3 shkolla: “ Naim Frasheri ” , “Thimi Mitko” dhe Ramiz Sadiku”, me të cilat u punua nga 2 ditë me qëllim të adaptimit të treguesve dhe pyetësorëve sa i për këtë formulim por edhe pjesës përmbajtësore të tyre. Në Dhjetor të vitit 2010, versioni i Indeksit për gjithëpërfshirje, i adaptuar në gjuhën shqipe, u botua dhe u shpërnda në shkollat, drejtorit komunal të arsimit, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, etj. Në vitin 2011. Indeksi për gjithëpërfshirje vazhdoi në 3 shkollat të cilat ishin përfshirë në fazën e adaptimit të udhëzuesit. Pas 3 ditëve të trajnimit të mbajtur me këto shkolla, u themeluan ekipet bashkërenduese në nivel shkollor. Në vitin 2012 – 2013, projekti zgjeroi numrin e institucioneve arsimore në 16, ku prej tyre ishin përfshirë 8 institucione parashkollore dhe 8 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në 7 komuna të Kosovës të përmendura në tabelën më poshtë:

NR.	EMRAT E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE DHE SHKOLLAVE	KOMUNA
1	IP “Buzëqeshja”	Prishtinë
2	IP “Gëzimi Ynë”	Mitrovicë
3	IP “Ardhëmëria Jonë”	Ferizaj
4	IP “Ardhëmëria I”	Gjilan
5	IP “INTEGJ”	Gjilan
6	IP “Pëllumbat e Paqes”	Pejë
7	IP “ Ganimete Terbeshi-Orize”	Gjakovë
8	IP “Motrat Qiriazit”	Prizren
9	Shkolla fillore “Migjeni “	Mitrovicë
10	Shkolla fillore “Tefik Çanga”	Ferizaj
11	Shkolla fillore “Thimi Mitko”	Gjilan
12	Shkolla fillore “Ramiz Sadiku”	Pejë
13	Shkolla fillore “Zekeria Rexha”	Gjakovë
14	Shkolla fillore “Ibrahim Fehmiu”	Prizren
15	Shkolla fillore “Naim Frashëri”	Prishtinë
16	Shkolla fillore “AntonZako Çajupi”	Mitrovicë

Tabela 3:Lista e Institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore

Në secilin institucion parashkollor dhe shkollë fillore janë organizuar trajnime 3 ditore ku janë dhënë informata rreth procesit të zbatimit të Indeksit sipas 5 fazave siç i parasheh dokumenti dhe në të njëjtën kohë janë hartuar edhe plani dinamik kohor për secilën fazë.

Procesi i zbatimit të Indeksit në institucione parashkollore dhe shkolla kalon nëpër 5 faza të cilat përmbushin njëra tjetrën. Megjithatë, zhvillimi i shkollës nuk duhet të shihet si një proces mekanik. Ky zhvillim është rrjedhojë e krijimit të ndërlydhjeve mes vlerave, emocioneve, veprimeve, mendimeve, analizave dhe planifikimit të kujdesshëm.

Për përmbushjen e aktiviteteve që parashihen në secilën fazë, institucionet Parashkollore dhe shkollat kanë themeluar ekipet bashkërenduese sipas udhëzimeve të dhëna dhe kanë vazhduar punën nëpër faza të ndryshme. Secila fazë ka zgatur rreth 2-3 muaj, konform shkallës së aktiviteteve që parashihen të realizohen për secilën fazë. Me qëllim të mbështetjes profesionale të këtyre institucioneve, Save the Children angazhoi 2 ekspertë për monitorimin e aktiviteteve nëpër secilën fazë. Takimet zhvilloheshin në shkollat ku pas çdo faze diskutoheshin për shkallën e realizimit të aktiviteteve, vështirësitë, planet e mëtejshme, etj.

Tabela 4: Monitorimi për Institucione Parashkollore dhe Shkolla

TABELË MONITORIMI PËR INDEKsin PËR GJITHËPËRFSHIRJE				
Institucioni Parashkollor/shkolla		Data		
Fazat e zhvillimit të Indeksit për gjithëpërfshirje	Të arriturat	Sfidat/penge-sat	Aktivitetet e planifi-kuara për zhvillim	Komen-tet e moni-toruesit
<p>Faza 1</p> <p>Fillimi i punës me Indeks</p> <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i grupit bashkërendues. Shqyrtimi i qasjes në zhvillimin e shkollës. Vetëdijesimi për Indeks Shtjellimi i njohurive ekzistuese. Thellimi i analizës duke përdoruar treguesit dhe pyetjet. Përgatitja për të punuar me grupet tjera. 				
<p>Faza 2</p> <p>Informatat për shkollën</p> <ul style="list-style-type: none"> Shtjellimi i njohurive të punonjësve dhe drejtorëve. Shtjellimi i njohurive të nxënësve. Shtjellimi i njohurive të prindërve dhe komunitetit. Caktimi i prioriteteve për zhvillim. 				
<p>Faza 3</p> <p>Krijimi i një plani zhvillimor për përfshirje në shkollimin fillor</p> <ul style="list-style-type: none"> Futja e kornizës së Udhëzuesit në planin zhvillimor të shkollës. Futja e prioriteteve në planin zhvillimor të shkollës. Ekipi punon në rishikimin e planit zhvillimor. Ekipi vendos për shkollën e ndryshimit të planit në bazë të punës me Udhëzues. 				
<p>Faza 4</p> <p>Përmbushja e prioriteteve (në vazhdimësi)</p> <ul style="list-style-type: none"> Vënia e prioriteteve në praktikë. Zhvillimi i vazhdueshëm. Shënimi i përparimeve. 				
<p>Faza 5</p> <p>Përmbushja e prioriteteve (në vazhdimësi)</p> <ul style="list-style-type: none"> Vënia e prioriteteve në praktikë. Zhvillimi i vazhdueshëm. Shënimi i përparimeve. 				

Kjo formë e mbështetjes vazhdoi deri në përfundimin e fazës së katërt në të cilën parashihet përfshirja e Indeksit në planet zhvillimore të shkollës. Me këtë rast është organizuar takimi i përbashkët i të gjitha shkollave ku janë prezantuar të arriturat, problemet që kanë hasur dhe planet për të ardhmen.

Tabela 5: Përfshirja e Indeksit në Planin zhvillimor të shkollës –model nga shkolla fillore “Migjeni” Mitrovicë

Fusha e cilësisë	Aspektet e veçanta të fushave të cilësisë për periudhë trevjeçare	2013	2014	2015
1. Kultura, mësimi, cilësia e mësimdhënies dhe procesi i mësimi	Trajnimi dhe përgatitja e mësimdhënësve për vlerësimin e arritjeve-dijeve të nxënësve. Sipas standardeve të MASHT-it	Gjysëm-vjetori i dytë	Gjysëm-vjetori i parë	
2. Cilësia e mësimdhënies	Trajnimi i mësimdhënësve për metodologji ndërvepruese të mësimdhënies-me nxënës në qendër Identifikimi i problemeve të nxënësve me sukses të ulët në mësimnxënie.	Muaji IV –XII 2013	Muaji -I - XII	Muaji I- XII
3. Profesionalizimi i mësimdhënësve	Seminar-punëtori: përgatitja e mësimdhënësve për hartimin e planifikimit vjetor dhe mujor në përputhje me dokumentet kurrikulare.	2013	2014	2015
4. Profesionalizimi i mësimdhënësve	Punëtori për përgatitjen – avancimin e mësimdhënësve për hartimin e planifikimit ditë-orë mësimor me objektiva specifike.	Muaji I-VI	Muaji I - VI	
5. Kultura gjithëpërfshirëse	Përgatitja dhe botimi i gazetës së shkollës, në gjuhët mësimore në të cilat zhvillohet mësimi me pjesëmarrjen edhe të grupeve të marginalizuara.	Muaji IV-VI	Muaji – IV-VI	Muaji –IV-VI

6. Metodologjia e hulumtimit

Për mbledhjen e të dhënave është shfrytëzuar qasja kualitative hulumtuese. Opinione janë marrë përmes intervistave të tipit të hapur. Intervistat janë zhvilluar me edukatorë, mësime, prindër dhe nxënës. Gjithashtu është organizuar edhe një fokus grup me stafin menaxhues të shkollës. Hulumtimi është realizuar në periudhën tetor 2013 – shkurt 2014.

Tabela 6 :Institucionet e përfshira në hulumtim dhe numri i pjesëmarrësve

Nr	Institucioni / shkolla	Vendi Komuna	Edukatore Mësime Nr:	Prindër Nr:	Nxënës Nr:
1	IP "Gëzimi ynë"	Mitrovicë	10	10	
2	IP "Pëllumbat e paqes"	Pejë	10	10	
3	IP "Ganimete Tërbeshi"	Gjakovë	10	10	
4	IP "Ardhmëria I"	Gjilan	10	10	
5	IP "INTEGJ"	Gjilan	10	10	
6	Sh F & MU "Migjeni"	Mitrovicë	10	10	10
7	Sh F & MU "Tefik Canga"	Ferizaj	10	10	10
8	Sh F & MU "R. Sadiku"	Pejë	10	10	10
9	Sh F & MU "Thimi Mitko"	Gjilan	10	10	10
10	Sh F & MU "Motrat Qiriazit"	Prizren	10	10	10
	Gjithsej		100	100	50

Tabela 7: Pjesëmarrësit në fokus grup

Nr	Emri e mbiemri	Institucioni	Vendi	Profesioni/ Pozita
1	Fexhrije Halimi	IP "Buzëqeshja"		Edukatore mbështetëse
2	Gjejlon Begolli	IP "P. E paqes"	Pejë	Drejtoreshë
3	Melihate Meha	ShF&MU "A.Z.Cajupi"	Mitrovicë	Drejtoreshë
4	Refik Azemi	Zyrtar në DKA	Mitrovicë	Udhëheqës
5	Selim Zogaj	ShF&MU "I. Fehmiu"	Prizren	Mësime
6	Resmije Rashiti	ShF&MU "T.Canga"	Ferizaj	Edukatore mbështetëse
7	Ermira Pruthi	Save the Children	Prishtinë	Zyrtare e projektit
	Dhurata Nixha	Save the Children	Prishtinë	

7. Praktika të mira nga zbatimi i Indeksit në institucione parashkollore dhe shkolla

Me qëllim të pasqyrit sa më të mirë të rezultateve dhe vështirësive të zbatimit të Indeksit, janë bërë anketa me mësime, nxënës dhe prindër. Pyetësorët kanë qenë të përbërë prej disa pyetje mbi të cilat kanë reflektuar mësime, nxënës dhe prindër. Gjithashtu, është shfrytëzuar edhe fokus grupi ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga komuna, drejtorët e shkollave dhe institucioneve parashkollore, mësime, edukatorët dhe përfaqësuesit nga Save The Children të cilët kanë reflektuar lidhur me procesin e zbatimit të Indeksit, përfshirë edhe përparësitë dhe vështirësitë që janë evidentuar gjatë këtij procesi.

Informatat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve lidhur me Indeksit për gjithëpërfshirje.

Sa janë të njoftuar mësime, prindër dhe nxënës?

Nga analizimi i intervistave rezulton se me zbatimin e Indeksit për gjithëpërfshirje janë të njoftuar dhe se janë dëshmitarë për efektin pozitiv të zbatimit të tij.

Shumica e mësimeve, prindërve dhe nxënësve kanë shprehur se kanë informacion në lidhje me zbatimin e tij. Kjo argumentohet me qëndrimet e tyre si vijon:

Mësimeve:

- Tani në shkollën tonë zhvillohen aktivitete që nuk kanë ndodhur më parë.
- Funkcionon grupi bashkërendues.
- Janë zhvilluar trajnime mbi tematika të cilat kanë dalur prioritare gjatë hulumtimit.
- Janë zhvilluar hulumtime (gjë e cila nuk ka ndodhur më parë).

Prindër:

- Kanë kërkuar ide prej neve.
- Ka nisur zbatimin e Planit Individual të Arsimit.

Nxënës:

- E dimë se funksionon një grup i rëndësishëm
- Mësime tanë marrin pjesë shpesh në takime

Mësimdhënësit janë shprehur në përgjithësi se kanë informacione për zbatimin e Indeksit për gjithëpërfshirje, por edhe një numër i konsiderueshëm i prindërve (16) dhe nxënësve (12).

Kjo tregon se Indeksi për gjithëpërfshirje është kuptuar dhe se mësimdhënësit janë familjarizuar me përmbajtjen, filozofinë dhe metodologjinë e tij. Në anën tjetër, fakti që një numër i konsiderueshëm i prindërve dhe nxënësve nuk kanë informacione, shtron nevojën e punës së mëtejshme me prindër dhe me nxënës.

Ndryshimet në institucion dhe ndryshimet tek mësimdhënësit si rezultat i zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje

Tabela 8: Ndryshimet në institucion

Këndvështrimi i mësimdhënësve	Këndvështrimi i prindërve	Këndvështrimi i nxënësve
Janë identifikuar problemet Janë hartuar plane; Janë përcaktuar prioritetet Është fituar një projekt; Vetëdijesim më i madh i mësimdhënësve; Zhvillohet mësim i diferencuar; Janë reduktuar mungesat e nxënësve; Ndhimë më e madhe ndaj fëmijëve/nxënësve me vështirësi në mësim; Përfshirje e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë të rregullta; Përfshirje më e madhe e komunitetit RAE. Përfshirja e prioritetëve që kanë dalë nga hulumtimet në nivel shkollor në Planin zhvillimor të shkollës	Mësimdhënësit janë më të hapur ndaj fëmijëve dhe ata ndihen më të pranuar e të sigurtë; Për herë të parë (2013) pranohet një fëmijë me autizëm në shkollën tonë; Ambient më i mirë në shkollë; Bisedohet më shumë për të drejtat e fëmijës; Janë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.	Sjellja e mësimdhënësve është më e mirë; Ka më pak mungesa; Janë zvogëluar etiketimet; Mirëpritje më e madhe ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta; Është rregulluar infrastruktura fizike; Vijueshmëri më e madhe e nxënësve të komunitetit RAE.

Përkundër qëndrimeve pohuese për ndryshimet në institucion, një numër i konsiderueshëm i prindërve (26) dhe nxënësve (10) janë shprehur se nuk vërejnë ndryshime. Prandaj, edhe në këtë pikë, duhet përqendruar në aktivitete nga të cilat do të hetoheshin ndryshime të prekshme.

Ndryshimet te mësimdhënësit

Mësimdhënësit shprehen se zbatimi i Indeksit për gjithëpërfshirje ka ndikuar shumë tek ata në qëndrimet dhe punën e tyre. Ata shprehen, si vijon:

Mësimdhënësit:

- Ndhemi në përgjithësi më të përkrahur;
- Bashkëpunim më i madh ndërkolegial në shkollë;
- Motivim më i madh për punën me fëmijë/nxënës me vështirësi në mësim;
- Ambient më miqësorë në shkollë ("jam më e lumtur në punën time");
- Kemi më shumë informata, modele pune për përfshirje aktive të nxënësve.

Nxënësit:

- Mësimdhënësit janë më të hapur;
- Na trajtojnë më mirë;
- Na ndihmojnë më shumë.

Aktivitetet në institucion/shkollë dhe përfshirja e prindërve

Edukatorët dhe mësimdhënësit janë shprehur se si rezultat i zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje, janë shtuar aktivitetet në institucion/shkollë. Kjo vërehet nga shtimi i numrit të takimeve dhe temave që janë diskutuar.

Aktivitetet /temat:

- Politikat dhe praktikat gjithëpërfshirëse;
- Mundësitë e zbatimit më efikas të Indeksit për gjithëpërfshirje;
- Mundësia e përfshirjes së fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta;
- Puna me fëmijë me autizëm;
- Puna me fëmijë me Sindromin Daun;
- Lojërat gjithëpërfshirëse;
- Format e socializimit të fëmijës;
- Hartimi i Planit Individual të Arsimit;
- Masat për reduktimin e mungesave të nxënësve.

Gjithashtu, edukatorët dhe mësimdhënësit janë shprehur se në fillim kanë pasur vështirësi në zbatimin e Indeksit për gjithëpërfshirje sepse ekzistonte një hezitim i stafit për t'u angazhuar dhe një bashkëpunim jo i mirë që ishte si vazhdimësi e një tradite të gjatë, gjë e cila me kalimin e kohës u evitua dhe tani është gjendja shumë më e mirë në krahasim me atë fillestare.

Në anën tjetër, prindërit janë shprehur se janë përfshirë në aktivitete, përkatësisht janë pyetur për gjëra në lidhje me nxënësit/fëmijët e tyre.

Prindërit

Jemi pyetur nganjëherë dhe kemi dhënë ide e sugjerime për mbarëvajtje të procesit mësimor;
Kemi biseduar rreth mundësive më të mëdha të bashkëpunimit;
Kemi dhënë ide rreth funksionimit të disiplinës në shkollë.

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i tyre (32), shprehen se nuk janë konsultuar dhe së në aktivitete të institucionit/shkollës janë ftuar vetëm me rastin e festave të ndryshme. Kjo tregon se ende vazhdon praktika e vjetër ku prindërit ftohen në shkollë vetëm me rastin e festave apo ditëve të caktuara. Për këtë arsye, shtrohet nevoja për punë më të madhe në drejtim të përfshirjes së prindërve në aktivitetet e institucionit. Në këtë kuptim, duhet paraparë një plan të punës ku do të detajoheshin aktivitete të institucionit me përfshirje aktive të prindërve.

Tabela 9: Rekomandime nga edukatorët / mësimmshënësit, prindërit dhe nxënësit

Edukatorët/mësimdhënësit	Prindërit	Nxënësit
<ul style="list-style-type: none"> Përmirësim i kushteve infrastrukturore; Inkuadrim në shkollë i bashkëpunëtorëve profesionalë (pedagogut, psikologut, etj.); Inkuadrimi i mësimmshënësve mbështetës; Vlerësim i nxënësve nga një Komision i formuar; Zvogëlim i numrit të nxënësve në klasa; Të përfshihen edhe shkollat tjera; Bashkëpunim edhe më i madh me Save the Children; Organizim i trajnimeve tjera; Mbikëqyrje më e madhe nga komuna dhe MASHT Mbështetje financiare 	<ul style="list-style-type: none"> Të vazhdohet me Indeks të Gjithëpërfshirjes; Zbatim i ligjeve dhe rregullore; Inkuadrim i pedagogut dhe asistentëve; Trajnime shtesë për mësimmshënës; Stimulimi mësimmshënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> Shkolla është një vend ku shpenzojmë orë të tëra, prandaj të bëhet edhe më gjithëpërfshirëse; Të zvogëlohet numri i nxënësve në klasa; Të përfshihen më shumë nxënës me nevojë të veçanta; Hapësirë më e madhe për zhvillimin e aktiviteteve rekreative; Të zbatohen rregullat më shumë dhe kodi i mirësjelljes.

Përzgjedhja e shkollave ka qene një element tjetër me rëndësi në suksesin e projektit pasi që në momentin e përzgjedhjes së shkollave i është kushtuar rëndësi shkollave që kanë pasur diversitet të nxënësve gjë që ka mundësuar që përmes Indeksit të krijohet një ambient me i përshtatshëm dhe mikpritës jo vetëm për nxënësit dhe komunitetin që janë në shkollë por edhe për ata nxënësit e rinjë.

Zyrtar në Drejtorinë Komunale për Arsim

Këndvështrimi mbi Indeks të Gjithëpërfshirjes në nivelin komunal dhe nga drejtorët e institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore

Nga niveli komunal, kjo shihet si një qasje e re e cila i ka sfidat e veta që nga koncepti i arsimit gjithëpërfshirës deri të realizimi i tij në praktikë. Gjithashtu, vlerësohet mënyra e konceptimit dhe e orientimit të projektit përmes dy komponentëve siç është ekipi mbështetës në nivelin komunal i përbërë nga përfaqësuesit e tri drejtorive si: drejtorja për arsim, drejtorja për shëndetësi dhe drejtorja për mirëqenie sociale, pastaj punësimi i mësuesve mbështetës dhe përgatitja e shkollave përmes trajnimeve të ofruara nga projekti "Përfshirja e fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore në Kosovë", i implementuar nga zyra e Save the Children në Kosovë dhe e financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë.

Drejtor shkollë në SHF&MU "Anton Zako Qajupi" Mitrovicë
Gjithëpërfshirja është kuptuar drejt brenda shkollave.
Mësimdhënës SHF&MU "Ibrahim Fehmiu" Prizren
Përfitimimi nga ana e fëmijëve, prindërve, komunitetit si rezultatet e përdorimit të Indeksit ka qene pikërisht sepse i ka thyer paragjykimet.

Përfshirja e komunës në këtë proces ka bërë që edhe puna me Indeks nga shkollat dhe kopshtet të merret me më seriozitet pasi që shkollat nuk kanë qenë të vetme në këtë proces.

"Për herë të parë jemi pyetur nga shkolla dhe kanë kërkuar ide prej neve"
"Mësimdhënësit janë më të hapur ndaj neve dhe nxënësve"

- Një prind

Ndërsa nga shkollat dhe drejtuesit e shkollave, Indeks shihet si një instrument dhe udhëzues shumë i rëndësishëm për të hulumtuar problemet dhe çështjet e ndryshme me të cilat ballafaqohen shkollat. Për më tepër, ata besojnë që kjo ka ndikuar edhe në ngritjen e kapaciteteve të shkollës që vetë t'i identifikojë problemet, sfidat por edhe të bëjë përpjekje që me kapacitetet dhe resurset e brendshme njerëzore dhe financiare të shkollës t'i adresojë dhe zgjidhë problemet e ndryshme të identifikuara.

Indeksi për gjithëpërfshirje ka krijuar mundësi në tejkalimin e paragjytimeve dhe problemeve që kemi me përfshirje dhe ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët me nevoja të veçanta

Mësimdhënës SHF&MU "Ibrahim Fehmiu" Prizren

"Zbatimi i Indeksit na ka bërë hulumtues të mirëfilltë"

"Tani mund të hartojmë edhe projekte" Anetar e grupit bashkerendues

"Tefik Canga", Ferizaj

Përcaktimi i prioritetëve, të çështjeve për tu adresuar nga shkolla, por edhe përfshirja e tyre në planet zhvillimore të shkollave ka qenë elementi thelbësor të cilën e parasheh edhe vete Indeksi në mënyrë që kjo të behet një tradite e shkollave në vitet në vijim. Disa shkolla kanë shkuar më tej duke bërë edhe aktivitete të cilat kanë pasur si qëllim adresimin e atyre çështjeve që kanë dal nga hulumtimet që janë bërë në shkollë si: ligjërrata me prindër, aktivitete me nxënës për adresimin e dhunës, ngacmimeve, braktisjes së shkollës, parandalimit të dukurive të tjera negative në shkolla, etj. Ndërsa, rëndësinë dhe përparësitë e përdorimit të Indeksit në shkolla me shumë interes e shohin edhe mësimdhënësit të cilët theksojnë se në fillim ka pasur shumë vështirësi për shkak të mungesës së informacioneve të stafit dhe prindërve lidhur me rëndësinë e Indeksit dhe përfitimeve që mund të ketë shkolla. Ata theksojnë se për të arritur këtë është dashur të ecet me hapa të ngadalshëm, por me kalimin e kohës dhe pas përfshirjes edhe të stafit tjetër të shkollës, puna me Indeks është parë si e rëndësishme në përmirësimin e performancës së shkollës. Bashkëpunimi me komunitetin është rritë dhe kjo falë hulumtimeve që janë bërë me prindër ku përmes pyetjeve ata kanë pasur mundësi të reflektojnë lidhur me shkollën në përgjithësi. Gjithashtu, edhe vetë organizata Save the Children e cila e ka financuar projektin: Indeksi për gjithëpërfshirje në Kosovë, e konsideron të rëndësishëm këtë projekt meqë konsideron se iu ndihmon shkollave në ofrimin e një mundësie që ato me ndihmën e Indeksit të krijojnë një ambient të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët.

Në veçanti konsiderojnë që Indeksi ka krijuar mundësi në tejkalimin e paragjytimeve dhe problemeve që kanë me përfshirje dhe ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët me nevoja të veçanta dhe për këtë arsye kanë përdorë qasje më holistike dhe trajnimet e organizuara në mënyrë që të trajtojnë konceptin e gjithëpërfshirjes në krijimin e ambienteve me gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët.

Opinione nga fokus grupi, përparësitë e përdorimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet parashkollore dhe shkolla

- Përdorimi i Indeksit ka pasur shumë gjëra pozitive pasi që ka qenë shumëdimensional dhe ka ndikuar në shkollat të bëhen më të hapura dhe më miqësore për stafin, nxënësit dhe komunitetin dhe po ashtu ka rritë nivelin e bashkëpunimit.
- Punësimi i edukatoreve dhe mësuesve mbështetës ka mundësuar rritjen e kapaciteteve të shkollave dhe kopshteve për të mbështetur fëmijët dhe nxënësit brenda shkollës dhe kopshtit.
- Shkollat janë tani të informuara për konceptin e gjithëpërfshirjes.
- Është shtuar numri i aktiviteteve me nxënës brenda shkollave.
- Është rritë bashkëpunimi me prindër dhe komunitetin.
- Janë organizuar trajnime për PIA dhe mësuesit po i përdorin ato.
- Është rritë numri i nxënësve me vështirësi në të nxënë që janë përfshirë në shkolla dhe Planin Individual.
- Është rritë bashkëpunimi mes stafit të shkollës.
- Janë organizuar takime të ndryshe me kolektiv ku janë trajtuar tema të ndryshme si dhuna në shkollë, braktisja e shkollës, etj., dhe me këtë rast shkolla ka avokuar për çështje të ndryshme.
- Janë motivuar mësimdhënësit për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta të cilët tani janë në klasa të rregullta.
- Nxënësit janë aftësuar të marrin iniciativë të ndryshme brenda shkollës për çështje të ndryshme.
- Është rritë vetëdijesimi i prindërve.
- Janë bërë trajnime të trajnerëve brenda shkollave.
- Nxënësit po shprehen më lirshëm për problemet e tyre.

Projektet e institucioneve parashkollore dhe shkollave

Zbatimi i Indeksit për gjithëpërfshirje ka ndikuar pozitivisht edhe në punën për hartimin e projekteve nga ana e mësimdhënësve. Hulumtimi dhe hartimi i projekteve nga institucionet konsiderohet si pikë e dobët, prandaj zbatimi i Indeksit ka zhvilluar të mësimdhënësit edhe shkathtësitë për hartimin e projekteve. Gjithashtu, institucionet ku është zbatuar Indeksi për gjithëpërfshirje kanë aplikuar dhe kanë fituar edhe projekte të tjera dhe mësimdhënësit janë shprehur se aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Indeksit kanë bërë që të zhvillohen edhe shkathtësitë për hartim të projekteve.

Pas një trajnimit të shkurtër dhe monitorimeve e konsultimeve praktike, disa institucione kanë hartuar dhe kanë fituar grante që janë ndarë nga organizata Save the Children dhe kanë zhvilluar aktivitete në institucione me tema që ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me gjithëpërfshirjen.

Tabela 10. Lista e institucioneve parashkollore dhe shkollave të cilat i kanë fituar grantet e ndara nga ana e Save the Children:

Nr.	Institucionet Parashkollore / Shkollat	Projektet
1	IP "Buzëqeshja" Prishtinë	Tejkalimi i sfidave dhe krijimi i vetëbesimit.
2	IP "Pëllumbat e Paqes", Peje	Gjithëpërfshirja në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
3	IP "Ardhmëria Jonë" Ferizaj	Ngritja e cilësisë së shkollës dhe ndërlidhja e Indeksit për gjithëpërfshirje në përmirësimin e performancës së shkollës.
4	IP "Intexh" Gjilan	Bashkëpunimi me komunitet dhe socializmi i fëmijëve në funksion të gjithëpërfshirjes.
5	I.P" Gëzimi Ynë", Mitrovicë	Ngritja e performancës së punës edukative.
6	IP "Ganimete Terbeshi Orize" Gjakovë	Për një kopsht gjithëpërfshirës.
7	IP "Ardhmëria" Gjilan	Bashkëpunimi reciprok edukatore-fëmije-prind
8	Shkolla Fillore "Zekeria Rexha" Gjakovë	Reduktimi i dallimeve, i mungesave, bashkëpunimi me prindër dhe krijimi i klasës gjithëpërfshirëse.
9	Shkolla fillore "Haziz Tolaj". Prizren	Përfshirja e metodave ndërvepruese për bashkëpunim dhe modifikim në kuadër të shkollës.
10	Shkolla fillore "Motrat Qiriazit" Prizren	Bashkëpunimi ndërkolegial dhe me prindër në funksion të gjithëpërfshirjes.
11	Shkolla fillore "Ibrahim Fehmiu" Prizren	Parandalimi i dhunës, avancimi i bashkëpunimit dhe reduktimi i braktisjes në shkollë.
12	Shkolla fillore "Naim Frasheri" Prishtinë	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
13	Shkolla fillore "Ramiz Sadiku" Peje	Gjithëpërfshirja në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
14	Shkolla fillore „Migjeni" Mitrovicë	Ngritja e kulturës gjithëpërfshirëse përmes identifikimit dhe trajtimit të pengesave (barrierave) në shkollë.
15	Shkolla Fillore "Andon Zako Çajupi" Mitrovicë	Të mësojmë duke luajtur.
16	Shkolla fillore "Thimi Mitko" Gjilan	Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve në ofrimin e shërbimeve adekuata për nxënësit me vështirësi në të nxënë.
17	Shkollat fillore "Tefik Çanga" Ferizaj	Gjithëpërfshirja në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Kemi pasur vështirësi në informimin dhe familjarizimin e stafit të shkollës me Indeks pasi që shkolla punon në 2 ndërrime dhe ka qenë e vështirë të organoizojmë takime me gjithë stafin.

Anetar e grupit bashkërendues "Thimi Mitko" Gjilan

8. Sfidat /vështirësitë e zbatimit të Indeksit në institucionet arsimore në Kosovë

Zbatimi i Indeksit për gjithëpërfshirje në Kosovë është përcjellë me vështirësi të ndryshme në fazat e ndryshme të zbatimit. Vështirësitë kanë qenë të lidhura me fazat e zbatimit pasi që secila fazë i ka specifikat e saja nëpër të cilat kalon institucioni dhe duhet të zhvillojë aktivitete të cilat shpesh herë kërkojnë gatishmëri dhe vendosmëri të stafit të institucionit arsimor dhe komunitetit në mënyrë që të ndodhin ndryshimet e dëshiruara.

Indeksi për gjithëpërfshirje ka 5 faza të zhvillimit dhe secila fazë i ka specifikat të cilat duhet të përcjellën me shumë kujdes sepse secila fazë është parakusht i rëndësishëm për të kaluar në fazën tjetër dhe në disa raste kur psh. në fazën e parë të punës nuk është punuar sa duhet në informimin e stafit dhe familjarizimin e punës me Indeks atëherë kjo ka vështirësuar fazën e dytë, tretë etj. Kjo varet shumë nga angazhimi i burimeve njerëzore brenda shkollës si psh. drejtori i shkollës si personi kyç i cili e mbështet dhe monitoron punën e grupit bashkërendues në të gjitha fazat e punës me Indeks.

Nga përvoja me shkolla dhe institucione parashkollore disa sfida kanë qenë të përbashkëta për të gjitha institucionet por ka pasur edhe sfida të cilat kanë dalluar nga institucioni në institucion. Sfidë e përbashkët ka qenë informimi i stafit të institucionit për rëndësinë e zbatimit të Indeksit pasi që në trajnime janë përfshirë 20-25 persona nga secili institucion dhe në disa shkolla numri i stafit ka qenë shumë më i madh dhe meqë informimi apo trajnimi për pjesën tjetër të stafit është bërë nga grupi bashkërendues kjo ka sjellur vështirësi në disa raste. Sfidë tjetër ka qenë edhe puna e grupit bashkërendues brenda shkollës. Në disa shkolla, grupi bashkërendues nuk ka qenë shumë aktiv dhe nuk kanë pasur sa duhet përkrahjen e drejtorit të shkollës dhe rrjedhimisht edhe të stafit tjetër të shkollës.

Vështirësi të theksuara janë vërejtur edhe në përdorimin e udhëzuesit sidomos në fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të Indeksit, kjo, mund të ketë qenë për shkak se grupi bashkërendues nuk ka qenë i njoftuar sa duhet me dokumentin dhe me përdorimin e tij, sidomos me përdorimin e indikatorëve të Indeksit për të identifikuar nevojat brenda shkollës. Kjo ka bërë që pyetësorët që janë hartuar dhe përdorë nga ana e shkollave nuk kanë pasur fokus të qartë të qëllimit të hulumtimit dhe rrjedhimisht edhe rezultat e fituara nga hulumtimet nuk kanë sjellë risi apo informacione që nxisin institucionin të veprojë në drejtim të adresimit të problemeve të identifikuara. Vështirësi janë vërejtur edhe në adresimin e prioritetëve të identifikuara nga shkolla të cilat kanë dalë si rezultat i hulumtimeve të zhvilluara brenda shkollës dhe diskutimeve që janë bërë me stafin qoftë në përfshirjen në planin zhvillimor të shkollës qoftë edhe në zhvillimin e aktiviteteve për t'i adresuar ato. Arsyet janë të ndryshme. Në disa shkolla ishte e vështirë që stafi të angazhohej për shkak se shkolla punonte në dy ndërrime, arsyeja tjetër ishte angazhimi i stafit jashtë orarit të punës së rregullt dhe kjo kryesisht ishte në baza vullnetare por jo si çështje e një politike apo praktike të shkollës dhe mungesa e mjeteve financiare bënte që aktivitetet të realizoheshin pjesërisht por ka edhe raste kur nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë konkrete. Në përgjithësi

mund të konkludohet që viti i parë i punës me Indeks është me tepër një vit kur shkolla dhe stafi i shkollës duhet të njoftohen dhe t'i adaptohen pasi që mungon kultura për gjithëpërfshirje dhe puna ekipore në shkollë dhe si e tillë e vështirëson edhe punën me Indeks andaj, duke marr parasysh vështirësitë e identifikuar dhe arsyet e cekura më lartë, kjo mund të shihet si normale në vitin e parë të punës së këtyre institucioneve me Indeks.

9. Konkluzione dhe rekomandime

Indeksi për gjithëpërfshirje është një udhëzues i përdorshëm dhe i rëndësishëm për kopshte dhe shkolla e sidomos në promovimin e gjithëpërfshirjes në arsim. Këtë e tregojnë edhe studimet e ndryshme që janë bërë në vendet tjera por edhe në këtë hulumtim i cili tregon se përdorimi i këtij udhëzuesi ngritë kapacitetet e shkollave dhe kopshteve për të identifikuar dhe trajtuar problemet dhe çështjet të ndryshme me të cilat mund të ballafaqohen këto institucione në punën e tyre të përditshme. Kjo ka rëndësi e sidomos në shfrytëzimin më të mirë të resurseve të shkollës dhe rritjes së bashkëpunimit me komunitetin me qëllim që shkolla të jetë një institucion gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e komunitetit. Bazuar në këto praktika të mira të cilat janë evidentuar nga përdorimi i Indeksit për gjithëpërfshirje në Kosovë, rekomandojmë:

- Indeksit për gjithëpërfshirje të jetë pjesë e politikave të MASHT-it me qëllim të promovimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë;
- Të vazhdojë përkrahja e Drejtorive Komunale të Arsimit për promovimin e rëndësisë së përdorimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet arsimore;
- Drejtoritë Komunale të Arsimit të vazhdojnë mbështetjen e vazhdimësisë së përdorimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet që kanë punuar me Indeks në mënyrë që të bëhet pjesë e kulturës së institucioneve.
- Modelet pozitive të krijuara në kopshtet dhe shkollat ku është zbatuar Indeksit për gjithëpërfshirje të zgjerohen edhe në kopshtet dhe shkollat tjera me qëllim të krijimit të zgjerimit të rrjetit të kopshteve dhe shkollave që ofrojnë ambiente gjithëpërfshirëse;
- Kopshtet dhe shkollat që kanë përdorë Indeksit të vazhdojnë hulumtimet në fushat ku kanë më shumë mangësi apo në fushat ku dëshirojnë të rrisin performancën e tyre, duke përfshirë të gjithë akterët brenda dhe jashtë shkollës;
- Institucionet shkollore të vazhdojnë dhe intensifikojnë punën veçmas me prindër dhe nxënës në mënyrë që edhe ata të jenë pjesëmarrës dhe vendimmarrës në institucionet ku fëmijët e tyre janë të përfshirë;
- Krijimi i rrjetit të kopshteve dhe shkollave të cilat kanë punuar me Indeks për gjithëpërfshirje me qëllim të këmbimit të përvojave dhe promovimit të tij nëpër shkolla të tjera;
- Indeksit për gjithëpërfshirje të vazhdojë të promovohet edhe përmes programeve në nivelin e arsimit të lartë si lëndë e veçantë apo në kuadër të ndonjë lënde të caktuar siç mund të jetë në kuadër të lëndës së edukimit gjithëpërfshirës apo lëndëve të tjera të ngjashme.
- Indeksit të trajtohet edhe në programet e ndryshme të trajnimeve të cilat organizohen nga komunat, partnerët apo OJQ- të të ndryshme.

Literatura

- Booth, Tony. Ainscow, Mel. Përshtatur në gjuhën shqipe nga Zabeli, Naser dhe Behluli, Lulavere). 2011. Indeksi për gjithëpërfshirje. Prishtinë: Save the Children.
- Deklarata për të Drejtat e Njeriut Prishtinë.
- Fletë informacioni, F.SH.D.P.Tiranë, 2001.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Prishtinë.
- Korniza e Kurikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011-MASHT.
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011.
- Plani individual i arsimit PIA, 2013
- Rieser, Richard. 2008. Implementing Inclusive Education, London: Commonwealth Secretariat.
- Reid, Gavin. Learning Styles and Inclusion. London: Paul Chapman Publishing
- Save the Children's experience (2008). Making School's Inclusive – How change can happen. London: Save the Children UK.
- Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet, 2011,
- Standardet për shkollat mike për fëmije IPK, 2012
- Stangvik, G. (1997), Beyond Schooling: Integration in a policy perspective. In S. J.
- Pilj, C. J. W Meijer & S. Hegarty (Eds.), Inclusive Education: a global agenda, London: Routledge
- UNESCO, 2009. Policy Guidelines on Inclusion in Education. PDF.
- UNESCO, 2008. Every Learner Counts: 10 questions on inclusive education. www.unesco.org/education/inclusive.
- UNESCO, 2005. Guidelines for Inclusion – Ensuring Access to Education for All.
- Zabeli, dr. Naser, 2010. Edukimi inkluziv. Dispensë për student, Prishtinë, Wus Austria dhe Univerziteti i Prishtines.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016

Zabeli, Naser

Indeksi për gjithëpërfshirje fakte dhe opinione / Naser Zabeli,
Lulavere Behluli. – Prishtinë: Save the Children, 2014. – 32 f.:
ilustr. me ngjyra; 21 cm.

1. Behluli, Lulavere

Literatura : f. 32

ISBN 978-9951-534-34-5